



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



ZLAnr.32/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu, anëtarë dhe me zyrtarin e lartë ligjore Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD), paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Vushtrri, në seancën e panelit të mbajtur me 15.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET si e palejuar ankesa e subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD)

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankes nga përfaqësuesi i subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD), kundër Komisionit Komunal Zgjedhor-(KKZ), në Vushtrri, me të cilin pretendon se subjekti politik PD nuk e ka të drejtën e numrit të plotë të komisionerëve të KVV-ve për këto zgjedhje lokale me të vetmin arsyetim se nuk kemi përfaqësim në Kuvendin e Kosovës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi bazën juridike për paraqitjen e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli vlerëson se në rastin konkret PZAP-i nuk shqyrton dhe nuk vendos ndaj njoftimeve të KKZ-ve por vetëm ndaj vendimeve të KQZ-së dhe me këtë rast parashtuesi i ankesës nuk ka bazë ligjore për ankimimin e njoftimeve të KKZ-së, sepse është e specifikuar qartë në dispozitën ligjore të nenit 122 Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, se në cilat raste mund të ankimohen vendimet e KQZ-së.

Për arsyet e theksuara më lart dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL. Anr. 32/2017 më datën 15.09.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.